



Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 2664/2025
Data: 18.04.2025

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e tretë-III- për vitin 2025 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 19.03.2025 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin : **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë e Administratës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë e Zhvillimit Ekonomik), **Kimete Kuka-Hasallari** (Drejtoreshë e Shëndetësis dhe Mirëqenie Sociale), **Abdurrahman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë)

RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
- 2 .Takim me Drejtorinë e Administratës.
- 3.Takim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik.
- 4.Takim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
- 5.Eventuale

Zaim Bela thekson: Fillimisht dua të ju shpreh ngushëllime për vdekjen e antarit të këtij komiteti z.Mefail Suma , kisha nje propozim për zgjedhjen e kryesuesit të ri të komitetit për komitetit propozoj që Resul Suma të bëhet kryesuesi i Komitetit për Komunitete lidhur me këtë pike hapi diskutimin ; nese nuk ka e hedh në votim : rezultati i votimit ishte njëzeri

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2 .Takim me Drejtorinë e Administratës.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Natyra Kalisi thekson: Në drejtorinë e Administratës në vitin 2025 kemi fillu me disa procese të ndryshme drejt digjitalizimit të ofrimit të shërbimit ndaj qytetarve kemi vendosur pajisjen e një kompjuteri për nevoja të qytetarëve të cilet mund ta shfrytëzojnë atë për pajisje me dokumenta nga gjendja civile permes platformes ekosova do të thot jemi një nder komunat e para qe po e ofrojmë këtë shërbim pa pagese për qytetaret për printim për qasje në internet zyrtar pastaj edhe ndyshimi i rregullorës për taksa dhe tarifa ka pas një hap për shkak që është liruar barra administrative ku edhe zyrtarve ua kemi lehtësu punën për shkak se nuk detyrohen me shtyp fletëpagesa në mënyrë të vazhdueshme po të njëjtën kohe edhe qytëtarët e shohin një lehtësim të madh për shkak që kur të kryen një shërbim nuk ka nevojë për pagesa gjithashtu kemi nënshkruar marrveshje bashkëpunimi me Women 4Cyber Kosova një organizat që është rrjet i ballkanit me Maqedonin e Veriut në Shqiperi në Kroaci në Mal të zi në Bosnje dhe Hercegovine ku marreveshjen e ka nënshkru Kryetari i Komunës lidhur me trajnimet e stafit ktu brenda komunës me qëllim të ndergjegjsimit në aspektin e siguris e të dhenave dhe mbrojtjën e të dhenave personale brenda komunës ajo që pritët të realizohet gjat muajit prill është konference rajonale së bashku me misionin OSBE që do të perfshin njembëdhjet komuna qëllimi i kësaj konference është paraqitja e shembujve të mirë të praktikave që qeverisjes lokale ku edhe komuna jonë do të jetë nikoqir i këtij takimi , me tutje planifikojme me i zhvillu procedurat e prokurimit të cilet i kemi inicuar kemi planifiku që të vendosen dy televizione brenda objektit të komunës njeri do të jetë pran qendres për shërbim të qytetareve dhe te salla e takimeve do të zëvendsojmë projektorin me një televizor

3.Takim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik.

Kryesuesi thekson:- Fillimisht deshta të pyes rreth parkut të lodrave afër Komunës a do të rregullohet?

Majlinda Kaloshi thekson: Projekti i lodrave për femije e kanë aprovuar Kfori Italian me krye si donacion , këtë muaj kemi pas takimi me komandantin e Kforit Italian që ka ardhë këtu dhe që operon regjionin e Pejës dhe pjesën tonë deri në verë ka me përfunduar si projekt konfirmimin e kemi mbetet vetëm implementimi këto janë qeshtje të procedurave administrative.

Si drejtori këtë vit kemi për herë të parë investime kapitale janë dy projekte si ballkoni panoramik me një vlerë rreth 48.000 mijë euro dhe ndërtimi i parkut të pishat në Fshatin Goranc gjithashtu kemi me vazhdu me subvencionet edhe në këtë vit i kemi me rritje ku nga 10.000 mijë euro është rritur në 15.000 mijë euro gjatë këtij muaji kemi me hap thirrjen për aplikim të bizneseve , kemi nënshkru marrveshje me agjencionin e komplekseve memoriale

Kryetari së bashku me drejtorin e agjencionit për hartimin e projektit tek blloca 99 ku treni do të kthehet në muze

Zaim Bela thekson: Tek parku të pishat në Gorancë a do të këtë ujë dhe rrymë pasi që është e nevojshme

Majlinda Kaloshi thekson: Po ,gjithashtu edhe rruga do të rregullohet

4.Takim me Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillim Rural

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Abdurrahman Bushi thekson: Drejtoria e Bujqësisë gjatë vitit të kaluar së bashku me LAB dhe CVNP kemi bërë rrallimin e 4.85 hektareve të pyjeve të ulta publike në Puse të Nikës , kemi bërë edhe subvencionimin e fermereve nga drejtoria e bujqësisë janë subvencionuar dy sektorë sektori i bletarise ku kemi shpërndarë 2500 pogaqe kanë qenë përfitues 38 fermer dhe me pajisjet me mekanizëm bujqësor ku kemi ndarë 13 pajisje bujqësore përfitues kanë qenë 11 fermer , edhe këtë vit kemi vazhdu me subvencione të pëmtarisë jemi në fazën e prokurimit për shpërndarjen e 3.5 hektareve të fidaneve arë mull dhe kumbull . gjithashtu kemi vazhdu me trajtime të sektoreve të ndryshme së bashku me KDC

Kryesuesi thekson: Tek pëmtaria a jepen vetëm plantacionet apo edhe sistemet dhe lista e përfituesve a ka dalë ?

Abdurrahman Bushi thekson: Vetëm fidane , jo lista ende nuk ka dalë sepse është në procedurë të prokurimit

Ajnure Thaci thekson: Në qfarë gjendje janë pishat e mbjellura në fshatin Seqisht

Abdurrahman Bushi thekson: Janë tharë nuk kanë mundur me i'u mbijetu kushteve klimatike


Eventuale

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Kimete Kuka thekson: Ne mbledhjen e kaluar nuk kam mundur te marr pjese , sa i perket shëndetësis është ndryshuar orari i punës në 08:00 deri në 16:00 dhe janë shtuar dy sherbime falas pulmologjike dhe kardiologjike është me mbeshtetje të sharrcemit qe ka ndiku pozitivisht te komiteti

Mbledhja perfundoj në 14:45

Procesmbajtësja
Sara Berisha



Kryesuesi i Komitetit
Resul Suma

